

PËRMBLEDHJE E TAKIMIT TË GRUPIT TË KONTAKTIT TË TREGUT BANKAR
MBAJTUR NË SELINË QËNDRORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, MË 15 DHJETOR 2017

Në datë 15 dhjetor 2017, në ambjentet e Bankës së Shqipërisë u organizua mbledhja e rradhës e Grupit të Kontaktit me pjesëmarrjen e drejtuesve të departamenteve të thesarit të bankave të nivelit të dytë. Takimi u drejtua nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare, Z. Marian Gjermani, me pjesëmarrje kontribuuese me ftesë të DOM-it të Këshilltarit të FMN-së pranë BSH-së, Z. Guido Della Valle, dhe me përfaqësues të tjerë nga DOM-i. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga 14 banka.

Z. Gjermani prezantoi temat kryesore dhe çështjet për diskutim me të cilat pjesëmarrësit ishin informuar paraprakisht, ku përfshiheshin publikimi nga Banka e Shqipërisë i parashikimit të nevojës javore për likuiditet të sistemit bankar, zhvillimet ndërkombëtare në lidhje me normat referencë të interesit, pritjet për ecurinë e TRIBID/TRIBOR, si dhe pyetëtori në lidhje me ndërhyrjet e BSH-së në tregun e brendshëm valutor.

Tema:	Parashikimi i likuiditetit dhe implementimi i politikës monetare
Prezantoi:	Z. Alajdin Orizaj, Departamenti i Operacioneve Monetare

Takimi filloi me prezantimin e Z. Orizaj, përfaqësues nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Ndryshe nga praktika e shumicës së bankave qendrore të cilat kanë strukturë të njëjtë implementimi me të, aktualisht BSH-ja nuk publikon parashikime të likuiditetit të sistemit bankar, por vetëm të dhëna ex-post. Publikimi i parashikimeve për likuiditet ka disa përfitime, ndër të cilat mund të përmenden kuptimi më i mirë i strukturës së politikës monetare të BSH-së, kontributi pozitiv në transparencën dhe besueshmërinë ndaj bankës qendrore, dhe nxitja e pjesëmarrjes sa më racionale në ankandet e zhvilluara. Zgjidhja e propozuar nga ana e BSH-së është t'i sigurojë bankave të nivelit të dytë parashikimin e kushteve të likuiditetit të pritshëm dhe specifikimin e shumës së patregtueshme në likuiditetin e parashikuar. Në përfundim, syhonet që publikimi të përfshijë parashikimin e likuiditetit, bashkë me shumën referencë të alokuar, si dhe formulën e përdorur për përcaktimin e shumës së alokuar. Data e publikimit synohet të jetë 23 janar 2018.

Z. Gjermani e përqëndroi bisedën tek trajtimi i likuiditetit në terma neto, duke korrigjuar për likuiditetin që (nuk) tregtohet. Ai u shpreh se është mjaft e rëndësishme që bankat të konsiderojnë edhe pritshmëritë e tyre në lidhje me nevojat për likuiditet, përveç të dhënave faktike. Me synimin për të rritur fleksibilitetin e përdorimit të rezervës së detyrueshme, pritjet miratimi i Këshillit Mbikëqyrës për rritjen e kësaj vlere nga 40% në 70%. Gjithashtu, remunerimi i rezervës së detyrueshme në Lekë parashikohet të ndryshojë nga 70% në 100% të normës bazë të interesit. Volatiliteti i ulët duhet të vlerësohet si mundësi e mirë nga ana e bankave të nivelit të dytë për të qenë më aktiv në tregtim, ndërkohë që publikimi i të dhënave ex-ante të likuiditetit, krahas të dhënave ex-post, do t'i shërbejë atyre në këtë drejtim.

Tema:	Zhvillimet ndërkombëtare në lidhje me normat referencë të interesit
Prezantoi:	Guido Della Valle, Këshilltar i FMN-së pranë BSH-së

Takimi vijoi me prezantimin e Z. Guido Della Valle, përfaqësues i FMN-së në Bankën e Shqipërisë, me temë zhvillimet e fundit në normat ndërkombëtare të interesave LIBOR dhe

EURIBOR. Kjo normë referencë konsiderohet e paqëndrueshme dhe e padëshirueshme nga pjesëmarrësit në treg, të cilët mbështeten në norma interesi që nuk bazohen në tregje aktive, megjithë përmirësimet e rëndësishme që janë bërë.

Në vitin 2018 hyn në fuqi një rregullore e re e miratuar nga Këshilli Europian, dispozitat e së cilës përfshijnë: trajtimin e normave të referencës të bazuara në transaksione; nevojën për autorizimin e normave të referencës nga administratorët e tyre, në pajtim me vlerësimin pozitiv dhe në përputhje me dispozitat e rregullores; përmirësimin e administrimit të normës referencë, nëpërmjet përcaktimit të kriteve minimale; si dhe përforsimin e kontrolleve e prezantimit e regjimit sanksionues. Parashikimet afatgjata të Bankës Qëndrore Europiane për normat referencë të Euros janë negative. Ndërkohë, BQE-ja ka më shumë vështirësi në ruajtjen e besueshmërisë së EONIA (Indeksit mesatar njëditor të Euros), kur në të njëjtën kohë autoritetet rregullatore kanë shtrënguar rregullat në lidhje me normën referencë, duke bërë që bankat të mos marrin pjesë për shkak të shpenzimeve të larta. Gjithashtu, BQE-ja do të llogarisë dhe publikojë normën e saj të referencës bazuar në transaksionet njëditore, dhe po inkurajon zhvillimin e normave të reja “risk-free” në zonën e Euros. Në përfundim, e ardhmja e normave referencë të pasiguruara duket negative, si rrjedhojë e mungesës së një tregu likuid, por, nga ana tjetër, ka një përpjekje ndërkombëtare për të gjetur alternativa të tjera.

Z. Gjermani ra dakort me çështjet e paraqitura nga Z. Della Valle, duke u shprehur se në terma afatgjatë, norma referencë duhet të mbështetet mbi transaksione dhe jo mbi kuotimet e bankave, duke besuar që kjo tendencë në të ardhmen do të ketë efekt edhe në tregun shqiptar. Bankat duhet të tregojnë kujdes në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit në procesin e llogaritjes së TRIBID/TRIBOR dhe procesi i llogaritjes së normave duhet të jetë i kontrollueshëm nga kontrolli i brendshëm i tyre. Në vijim, çdo bankë duhet të informojë për situatën konkrete. Z. Gjermani ngriti shqetësimin për mungesën e pjesëmarrjes së disa bankave të nivelit të dytë në panelin e bankave, në procesin e llogaritjes së normave të referencës, duke shtuar se nëse kjo mungesë do të rritej, llogaritja e normave referencë të interesit nuk do të kishte kuptim.

Tema: Diskutim mbi kontratën e unifikuar të marrëveshjeve të riblerjes

Tema e tretë për diskutim ishte finalizimi i kontratës së unifikuar të marrëveshjeve të riblerjes. Bankat u nxitën të përfundojnë sa më shpejt formatin final të kontratës.

Tema: Diskutim mbi pyetësin në lidhje me ndërhyrjen e BSH-së në tregun e brendshëm valutor

Çështja e fundit e takimit kishte të bënte me pyetësin e dërguar nga Banka e Shqipërisë në lidhje me ndërhyrjet e saj në tregun e brendshëm valutor. Z. Gjermani theksoi rëndësinë e zhvillimit të ankandeve të suksesshëm, ku, ndër të tjera, synohet rritja e raportit bid/cover dhe ulja e diferencës ndërmjet çmimeve minimale dhe maksimale të ofruara nga ana e bankave të nivelit të dytë. Raporti me konkluzionet e pyetësit do t'i bëhet publik bankave të nivelit të dytë.